



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ALKET Z. MANÇKA  
ADRESA NR.2. ASIM ZENELI. NR.10.  
NR.6  
TEL: 694074311

## MARRËVESHJE SIGURUESE

Nr. repertori: 5302


Nr. koleksioni: 3917

Tirane më 28/12/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për miratimin e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Notarinë"

\*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



X2021051400433060408

Apdikent:

Alise Costello  
Alise



**MARRËVESHJE SIGURUESE**

Në Tiranë, sot më datën 28/12/2021 (dy mijë e njezet e nje) para meje Noteres Almet Hekusha me seli në "Banka e Tiranës", u paraqitën palët që kerkuan redaktimin e kësaj Marrëveshje Siguruese si më poshtë:

1- Shoqëria Tregtare "BALFIN-BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP" SH.P.K., me seli në adresën: Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë, regjistruar ne Organin Tatimor Tirane NUIS Nr.K72223031K, perfaqesuar në këtë kontratë ne baze te nenit 9.2.f të Statutit të shoqërisë nga Administratorja, znj. Edlira MUKA, e bija e Fetiut lindur më datë 03.02.1983 në Tiranë dhe banuese ne Rr.Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Ap.77, Tirane, mbajtëse e pasaportës me Nr.BF1783601 dhe me numër personal I35203147R, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar (tani e tutje quajtur "Barrëdhënës").

2- Shoqëria bankare "BANKA e TIRANES" SH.A, regjistruar si person juridik shqiptar me Vendimin Nr.12718, date 03.11.1995 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, qe vepron si BANKE me Licensen Nr.07, date 12.09.1996 te leshuar nga Banka e Shqiperise, NUIS J61924008V, me seli ne adresen Rruga " Ibrahim Rugova", Tirane, perfaqesuar nga Drejtori i Departamentit të SME, Ildir MEZINI, i biri i Fatosit, lindur më 28.10.1976 në Tirane, banues në Bulevardi "Bajram Curri", Pallati 298, Hyrja-16, Apartamenti 59, Tiranë, mbajtës i Leternjoftimit Nr.027969470, dhe Drejtores e Departamentit të Administrimit të Kredive, znj. Aida CENGU, e bija e Azemit, lindur me 16.02.1970 ne Kukes dhe banuese ne Tirane, me leternjoftim Nr. 035236532, te dy madhore e me zotesi te plote juridike per te vepruar. (tani e tutje quajtur "Barrëmarrës").

Barrëdhënësi dhe Barrëmarrësi bien dakord si vijon:

**Neni 1**

**KRIJIMI I BARRËS SIGURUESE DHE DETYRIMI I SIGURUAR**

1.1 Barrëdhënësi në këtë marrëveshje i jep Barrëmarrësit një barrë siguruese (së cilës tani e tutje i referohemi me emrin "Barrë Siguruese") mbi:

- (i) **100 (njeqind) kuota me vlerë 101,302,600 Leke (njeqind e nje milion e treqind e dy mije e gjashteqind lekë) të zotëruar prej Barrëdhënësit në kapitalin e shoqërisë "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" SH.P.K (NUIS Nr.L42304017T) dhe që përfaqëson 100% (njeqind përqind) të kapitalit të kësaj shoqërie; si dhe**
- (ii) **çdo kuotë të re të shoqërisë "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" SH.P.K, letër me vlerë, të drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (qoftë me anë të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimin, këmbimin ose ndryshe) në lidhje me ose mbi cilëndo kuotë që mund të fitohet në të ardhmen prej Barrëdhënësit nëpërmjet kapitalizimit të fitimeve, rritjes së kapitalit etj.; si dhe**

(iii) të gjitha të drejtat që rrjedhin në çdo mënyrë, direkt ose indirekt, nga zotërimi i Kolateralit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e dividendëve (fitimeve) dhe të drejtën e votimit në asamblenë e aksionarëve lidhur me Kolateralin;

(të cilave bashkërisht (i), (ii) dhe (iii) tani e tutje do t'i referohemi si "Kolateral").

Barra Siguruese e dhënë këtu siguron pagimin, përmbushjen dhe shlyerjen e kredise bankare që Kredimarrësi shoqëria "ALBCHROME" shpk (NUIS.K11613001M) ka marre prane Barremarresit, sipas Kontrate per Dhenie Kredie Bankare ne nje Llogari Rrjedhese (OVERDRAFT) Nr.CO.1145/21.12.2021, ne shumen 6,000,000 USD (gjashte milion dollare amerikane) dhe/ose ekuivalenti i kesaj shume ne monedhen Leke dhe/ose ekuivalenti i kesaj shume ne monedhen euro, akorduar nga Barrëmarrësi sipas të gjitha kushteve të parashikuara në to si dhe siguron pagimin e çdo shume që shoqëria "ALBCHROME" shpk, i detyrohet Barrëmarrësit në bazë të kontratave të sipër përmendura të kredive bankare apo të ndonjë shtojce të këtyre kontratave që do të lidhet midis palëve në të ardhmen (tani e tutje quajtur si "Detyrimi").

## Neni 2

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BARRËDHËNËSIT

2.1 Barrëdhënësi deklaron se:


- (a) është zotëruar ligjor me të drejta të plota i Kolateralit dhe ka të drejtë ta përdorë si garanci duke vendosur barrë siguruese mbi të;
- (b) Kolaterali është i lirë nga çdo barrë, pretendim i të tretëve ose pengesë tjetër ligjore;
- (c) kjo Marrëveshje përbën titull ekzekutiv në bazë të nenit 31 të ligjit "Për barrët siguruese".

2.2 Barrëdhënësi angazhohet dhe merr përsipër që:

- (a) gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje të mos caktojë ndonjë përfaqësues për ushtrimin e të drejtave lidhur me Kolateralin ose të transferojë (cedojë) të drejtat që rrjedhin nga Kolaterali;
- (b) gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje të depozitojë në një llogari të veçantë bankare pranë Barrëmarrësit të gjitha arkëtimet nga Kolaterali (dividend etj.);
- (c) në qoftë se i bëhet kërkesë, të japë me shkrim çdo informacion në lidhje me Kolateralin;
- (d) në qoftë se i bëhet kërkesë, të ekzekutojë, njohë apo japë detyra, transfera dhe dokumenta ashtu siç mund t'i kërkohet në mënyrë të arsyeshme nga Barrëmarrësi në mënyrë që t'i jepet efekt kësaj Marrëveshjeje, si dhe të paguajë të gjitha kostot e kërkimit dhe regjistrimit në regjistër;
- (e) t'i ripaguajë Barrëmarrësit shpenzimet apo kostot, duke përfshirë shpenzimet ligjore të bëra nga Barrëmarrësi për të vënë në ekzekutim këtë Marrëveshje ose për të ekzekutuar të drejtat e tij mbi Kolateralin, si dhe shpenzimet për regjistrimin e njoftimeve dhe kërkimin e informacionit në Regjistër në lidhje me barrën siguruese të krijuar nga kjo Marrëveshje;
- (f) të mos tjetërsojë Kolateralin ose çdo interes të lidhur me të (përfshirë këtu asetet dhe/ose aktivitetin e shoqërisë dhe/ose zmadhimin e kapitalit që mund të ndikojë në zvogëlimin e pjesëmarrjes së Barrëdhënësit në kapital) pa miratim të mëparshëm me shkrim të Barrëmarrësit;
- (g) të mos vendosë detyrime të tjera apo t'u japë të drejta reale të tretëve mbi kolateralin pa miratim të mëparshëm me shkrim të Barrëmarrësit;
- (h) të nënshkruajë dhe dërgojë menjëherë të gjitha dokumentat si dhe të marrë gjithë veprimet e nevojshme apo të këshillueshme në mënyrë që:
  - (i) të kompletojë dhe të mbajë në fuqi të plotë të Barrën Siguruese;



- (ii) të sigurojë që mbi të gjitha kuotat e ardhshme dhe të drejtat e shoqërisë të lidhura me to të nënshkruara nga Barrëdhënësi të jetë vendosur Barrë Siguruese në favor të Barrëmarrësit në përputhje me sa përcaktuar në Nenin 1 mësipër; dhe
- (iii) t'i mundësojë Barrëmarrësit të ushtrojë të drejtat dhe mjetet juridike që ai ka të drejtë në përputhje me këtë Kontratë, duke përfshirë, pa kufizime, të gjitha të drejtat dhe mjetet juridike të ushtrueshme pas ndodhjes së një Rasti Mospërmbushjeje.
- (i) t'i paguajë Barrëmarrësit shpenzimet apo kostot, duke përfshirë shpenzimet ligjore të bëra nga Barrëmarrësi në lidhje me pregatitjen ose ndryshimin e kësaj Marrëveshjeje, kompletimin apo ruajtjen e Barrës Siguruese, zbatimin në çdo formë të dispozitave ose ushtrimin e të drejtave, fuqive dhe mjeteve ligjore sipas Marrëveshjes apo sipas ligjit "Për barrët siguruese"
  - (i) të njoftojë Barrëmarrësin menjëherë për:
  - (ii) çdo ndryshim në të dhënat identifikuese të Barrëdhënësit ose të shoqërisë, pjesë të kuotave të së cilës përbëjnë Kolateralin;
  - (iii) çdo informacion mbi ekzistencën e ndonjë fakti që mund të shkaktojë pamundësinë e likuidimit të Kolateralit;
  - (iv) çdo Rast Mospërmbushjeje (siç parashikohen në nenin 4 më poshtë).



### Neni 3

### TË DREJTAT DHE DETYRIMET E BARRËMARRËSIT

- 3.1 Barra siguruese shtrihet ipso jure mbi të gjitha të ardhurat dhe përfitimet që rrjedhin nga Kolaterali. Si rrjedhim, Barrëmarrësi në përputhje me parashikimet e Nenit 550 të Kodit Civil, në rast mospërmbushjeje ka të drejtë të marrë, pa asnjë urdhër ose veprim tjetër nga Barrëdhënësi, çdo dividend, interes ose përfitim tjetër lidhur me Kolateralin dhe, në vijim, të kreditojë të ardhurat neto kundrejt Detyrimit.
- 3.2 Barra siguruese shtrihet mbi të gjitha të drejtat që rrjedhin në çdo mënyrë, direkt ose indirekt, nga zotërimi i Kolateralit, duke përfshirë por duke mos u kufizuar vetëm në të drejtën e dividendëve (fitimeve) dhe të drejtën e votimit lidhur me Kolateralin. Rrjedhimisht, gjatë kohëzgjatjes së kësaj marrëveshjeje dhe derisa nuk është vërtetuar ndonjë Rast Mospërmbushjeje, të drejtat e votës të lidhura me kuotat (Kolateralin), në asamblenë e ortakëve të shoqërisë, do të ushtrohen nga Barrëdhënësi, me kusht që këto të drejta të mos ushtrohen në asnjë rast nga Barrëdhënësi në një mënyrë të tillë që do të mund të çononte vlefshmërinë ose zbatueshmërinë e kësaj Marrëveshjeje dhe/ose e cila nuk është në përputhje me dispozitat e Kontratës të Kredisë apo çdo kontrate tjetër të lidhur me të.
- 3.3 Bazuar në barrën siguruese, Barrëdhënësi i kalon Barrëmarrësit, çdo dhe gjithë të drejtat që ka në bazë të ligjit dhe të statutit të si ortak në shoqërinë, kuotat e së cilës vendosen si Kolateral, si dhe të drejtën të marrë çdo kuotë të re, letër me vlerë, të drejta, të holla ose pasuri të lindura ose të ofruara në çdo kohë (qoftë me anë të kthimit, bonus, preferimit, të drejtave me kusht, zëvendësimin, këmbimin ose ndryshe) në lidhje me ose mbi cilëndo kuotë etj., pa qenë e nevojshme ndonjë urdhër ose veprim i mëtejshëm i Barrëdhënësit. Barrëdhënësi i kalon Barrëmarrësit të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore që ai ka ndaj shoqërisë në cilësinë e ortakut.
- (a) 3.4 Në vështrim të çdo dhe të të gjitha të drejtave dhënë Barrëmarrësit në bazë të kësaj Marrëveshjeje, Barrëmarrësi me vërtetimin e një Rasti Mospërmbushjeje do t'i dërgojë një njoftim Barrëdhënësit dhe Shoqërisë duke informuar se është vërtetuar një rast mospërmbushjeje dhe Banka ka të drejtë por nuk është e detyruar që:
  - (i) të ushtrojë të drejtat e votës që lidhen me kuotat, në asamblenë e zakonshme dhe në asamblenë e jashtëzakonshme të ortakëve të Shoqërisë; dhe

(ii) të përftojë të gjithë dividendët, interesat që lidhen me kuotat.

3.5 Çdo shpenzim i nevojshëm që Barrëmarrësi bën për ruajtjen e Kolateralit si dhe detyrimet ligjore në lidhje me të, ose çdo shpenzim gjyqësor ose jashtë gjyqësor që Barrëmarrësi bën lidhur me këtë Marrëveshje, janë në ngarkim të Barrëdhënësit dhe sigurohen nga Kolaterali.

#### Neni 4

#### RASTET E MOSPËRMBUSHJES

4.1 Vërtetimi i rrethanave të përshkruara më poshtë do konsiderohet mospërmbushje (tani e tutje i referohemi si "Mospërmbushje"):

- (a) dështimi për të përmbushur çdo lloj detyrimi, duke përfshirë pa asnjë kufizim mospagimin e principalit, interesave apo shuma të tjera që përbëjnë pjesë të Detyrimit të papaguar në kohën e duhur;
- (b) në qoftë se ndonjë deklaram i bërë nga Barrëdhënësi në lidhje me këtë Marrëveshje në përgjithësi dhe Kolateralin në veçanti, zbulohet të jetë i pasaktë;
- (c) në qoftë se Barrëdhënësi nuk përmbush detyrimin për të depozituar të ardhurat që rrjedhin direkt ose indirekt nga Kolaterali (dividend, etj) në llogarinë e veçantë bankare pranë Barrëmarrësit;
- (d) në qoftë se ndaj Barrëdhënësit duhet të ekzekutohet një vendim gjyqësor;
- (e) në qoftë se çdo palë tjetër që pretendon të ketë barrë siguroese mbi Kolateralin, ndërmer hapa për të ekzekutuar barrën e vet siguroese;
- (f) në qoftë se Barrëdhënësi shkel pikat (f) dhe (g) të nenit 2.2 të kësaj Marrëveshjeje;
- (g) në qoftë se, sipas mendimit të Barrëmarrësit, dhe mbi baza tregtare të arsyeshme, Barra Siguroese ose Kolaterali rrezikohen ose mund të vihen në rrezik.

#### 4.2 PËRSHPEJTIMI

Në rast mospërmbushje dhe në çdo kohë më pas, Barrëmarrësi nga ana e tij mund të deklarojë një pjesë ose të gjitha detyrimet që nuk konsiderohen të pagueshme me anë të kërkesës, të bëhen menjëherë të tilla pa bërë ndonjë kërkesë apo njoftim.

#### Neni 5

#### MJETET LIGJORE

5.1 Në rast Mospërmbushjeje, përveç të drejtave dhe mjeteve ligjore që parashikohen nga ligji, Barrëmarrësi mund:

- (a) të deklarojë, kur e gjykon të nevojshme, menjëherë si të detyrueshme për Barrëdhënësin që t'i paguajë të gjithë borxhin që i detyrohet, duke përfshirë Detyrimin e siguruar pa pasur nevojë për kërkesë ose njoftim të çdo lloji, dhe të arkëtojë të gjithë borxhin që i detyrohet me shpenzime të arsyeshme, përfshirë kostot e gjykatës, pagimin e avokatëve dhe shpenzime të tjera ligjore; dhe
- (b) përveç të drejtave të parashikuara më sipër dhe atyre që garantohen nga ligji, Barrëmarrësi ka, si para ashtu edhe pas Mospërmbushjes, të gjitha të drejtat dhe mjetet ligjore që i sigurohen nga Ligji "Për barret siguroese", duke përfshirë të drejtën për të shitur Kolateralin dhe të drejtën për pagimin e çdo lloj borxhi që Barrëmarrësit mund t'i sigurohet me ligj.

*[Handwritten signatures and initials]*

**Neni 6**  
**TË NDRYSHME**

- 6.1 Barrëdhënësi këtu autorizon Barrëmarrësin të regjistrojë formularët e njoftimit të regjistrimit në Regjistrin e Barreve Siguruese dhe dokumenta të tjerë dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet që Barrëmarrësi mund të mendojë se janë të nevojshme për të kompletuar dhe vazhduar kompletimin e Barrës Siguruese, për të mbrojtur dhe ruajtur Kolateralin dhe për të ekzekutuar Barrën Siguruese.
- 6.2 Barrëmarrësi mund të japë afate kohore shtesë ose lehtësira të tjera, kompromise, rregullime, të çlirojë ose të shkarkojë nga detyrimi apo të ndërmarrë veprime të tjera me Barrëdhënësin apo Kolateralin siç mund ta shikojë të arsyeshme pa paragjykuar përgjegjësinë e Barrëdhënësit apo të drejtat e Barrëmarrësit.
- 6.3 Kjo Marrëveshje është shtesë dhe jo zëvendësim i ndonjë barre tjetër siguruese që mbahet tani apo do krijohet në të ardhmen nga Barrëdhënësi, dhe kjo Marrëveshje është në dobi të palëve dhe e detyrueshme për to si dhe për personat që mund të zenë vendin e tyre ose të cilëve u janë transferuar të drejtat apo detyrimet.
- 6.4 Asnjë modifikim, ndryshim ose shtesë nuk mund t'u bëhet neneve të kësaj Marrëveshje, me përjashtim të rastit kur palët bien dakord me shkrim. Asnjë nen nuk mund të bëhet i pavlefshëm, përveçse kur është rënë dakord me shkrim nga palët.
- 6.5 Kjo Marrëveshje dhe transaksionet e tjera të parashikuara këtu duhet të shikohen e të interpretohen në përputhje me legjislacionin shqiptar që është në fuqi, duke përfshirë Ligjin "Për barret siguruese".
- 6.6 Çdo njoftim ose komunikim tjetër që kërkohet ose lejohet këtu quhet se është i mjaftueshëm në qoftë se jepet personalisht, është dërguar me postë të regjistruar ose faks, si vijon:

**(a) Për Barrëmarrësin:**

(Emri) "BANKA e TIRANËS" Sh.A.

(Adresa) Rr. "Ibrahim Rugova", Tiranë

**b) Për Barrëdhënësin:**

(Emri) BALFIN-BALKAN FINANCE INVESTMENT GROUP SHPK

(Adresa) Njesia Bashkiake Nr.2, Rr. "Papa Gjon Pali II", Ndertesa Nr.12, Kati 11-të, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010, Tiranë

ose, në çdo rast, në atë adresë që do jepet me shkrim nga çdo palë pjesëmarrëse ose të gjitha palëve të parashikuara këtu. Njoftimet apo komunikimet e bëra në këtë mënyrë do të quhen se janë dhënë në ditën e regjistrimit, pasi është postuar njoftimi ose komunikimi tjetër ose në datën e dorëzimit në rastin e një dorëzimi personal ose transmetimi me faks, duke pasur parasysh në rastin e faksit se është marrë konfirmimi i dërgimit.

- 6.8 Në rast se ndonjë nen i kësaj Marrëveshje, e cila mund të ndryshohet sipas rastit, shpallet i pavlefshëm ose i anulueshëm, pjesërisht ose tërësisht, nga një gjykatë me juridiksion kompetent, pjesa tjetër e Marrëveshjes vazhdon të ketë fuqi dhe efekt të plotë.
- 6.9 Në dëshmi të sa më sipër, kjo Marrëveshje nënshkruhet në pesë origjinale, nga një për palët kontraktuese, një për shoqërinë "ALBANIAN ENERGY SUPPLIER" SH.P.K një për Regjistrin e Barreve Siguruese dhe e pesta të mbahet nga Noteri Publik.

*[Handwritten signatures and stamps]*

VËRTETIM. që palët kanë hyrë në këtë Marrëveshje në ditën dhe vitin e shkruar më lart.

Kjo Marrëveshje Siguruese hartohet në bazë të ligjit "Për barrët siguruese" si dhe konform vullnetit të lirë të palëve, të cilët pasi e lexuan me zë të lartë dhe e kuptuan, me vullnetin e tyre të lirë e nënshkruan rregullisht dhe unë noterja e vërtetoj sipas ligjës.

**PALËT KONTRAKTUESE**

**BARRËDHËNËSI**  
**"BALFIN-BALKAN FINANCE**  
**INVESTMENT GROUP" SHPK**

*perfaqesuar nga:*

1.

*Elira Huka*



**BARRËMARRËSI**  
**"BANKA e TIRANËS" SH.A.**


*perfaqesuar nga:*

*Te Olin Merini*  
Drejtor i Departamentit SME

*Ardo Cepce*  
Drejtoresh e Departamentit te Administrimit te Kredive



**NOTERE**



*Ardo Cepce*



RECEIVED

RECEIVED



RECEIVED

Handwritten signature or text in the bottom right corner, possibly reading "Handwritten signature" and "Handwritten text".





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E  
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**




1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	K72223031K
2. Data e Regjistrimit	23/10/2007
3. Emri i Subjektit	Balfin - Balkan Finance Investment Group
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	11/09/2007
6. Kohëzgjatja	Nga: 11/09/2007
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia bashkiake nr.2, Rruga Papa Gjon Pali II, Ndertesa Nr.12, Kati 11, Zyra nr.1206, Kodi Postar 1010.
8. Kapitali	3.216.205.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00
9. Objekti i aktivitetit	(i) Investimi ne instrument financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asete (te prekshme apo te paprekshme), si dhe (ii) ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transakcion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise.
10. Administratori/ët	Edlira Muka

*Edlira Muka*  
*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

10.1 Afati i emërimit	Nga: 16/01/2020	Deri: 16/01/2025
 <p>11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)</p>	<p>Administratori/et perfaqeson/jne ligjerisht shoqerine. Administratori ushtron te gjitha fuqite e administrimit te zakonshem dhe te jashtezakonshem te Shoqerise, ne perputhje me nenin 95 te Ligjit nr 9901. date 14 mars 2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe vendimet e Asamblese se Pergjithshme. Per me shume qartesi, Administratori/et, pervec kompetencave te parashikuara ne ligjin per shoqerite tregtare te sipershenuar, permes ketij Statuti, ka/ne te drejte vendimmarrje: a. per krijimin e Joint Venture dhe bashkepunimeve te cilit do lloji qofshin, qe kane te bejne me investim, financimin, fitim te drejtash apo pjesemarrjesh ne projekte ekzistuese apo te reja me nje vlere te barabarte dhe me te vogel se 5.000.000 (pese milion) euro; b. per shitjen, blerjen apo shkembimin e pasurive te paluajtshme dhe nenshkrimin e kontratave te siper marrjes ne lidhje me to te barabarte dhe me te vogel se 5.000.000 (pese milion) euro;c. per te angazhuar shoqerine, ne cilesine e kredimarrses, ne marredhenie kredie, perkundrejt institucioneve financiare te licensuara ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj, me tagra te plota dhe te pakufizuara, persa i perket shumave, kushteve, afateve te kredise si dhe ne pergjithesi per te angazhuar Shoqerine, me tagra te plota dhe te pakufizuara, ne amendimet e marredhenieve ekzistuese te kredimarrjes, perfshire por pa u kufizuar ne amendimin e shumave, kushteve dhe afateve, duke percaktuar ne cdo rast, lirisht, permbajtjen e kontratave apo akteve te lidhura me kredimarrjen e Shoqerise, duke pasur te drejte te nenshkruaje cdo kontrate te re kredie, amendim te kontratave ekzistuese te kredise, rinovim, riskedulim, ristrukturim, apo cdo dokument ose formular te kerkuar nga institucionet financiare, me te cilat shoqeria eshte ne marredhenie kredimarrje; d. per vendosjen e barreve apo kufizimeve mbi pasurite e luajtshme dhe/ose te paluajtshme te shoqerise ne favor te te treteve; e. per dhenien e garancive te cilit do lloji dhe angazhimin e shoqerise ne cilesine e garantorit dhe/ose dorezanesit (corporate guarantee) kundrejt te tjereve ne favor te te treteve:f. per te perfaqesuar shoqerine, me tagra te plota</p>	

*Apikant...*  
*[Signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

	dhe te pakufizuara, permes votimit ne cdo mbledhje asambleje ku shoqeria paraqitet si ortak apo aksioner, duke vendosur lirisht menyren e votimit, pa asnje kufizim te lidhur me ceshtjet e ngritura ne keto mbledhje asambleje, perfshire por pa u kufizuar edhe vendimmarrjen me tagra te plota dhe te pakufizuara per ceshtje te njejta me ato te listuara ne pikat e mesiperme (c,d,e).	
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Dega ne Shqiperi e Shoqerise ERNST & YOUNG - EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 01/01/2021	Deri: 31/12/2021
13. Ortakët	Samir Mane	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 3.216.205.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	1,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
<i>*Të përfaqësuarit, (Plotësohet vetëm nëse një kuotë zotërohet në bashkëpronësi)</i>		
13.4 Komente (nëse ka)		
14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Tirane Farke SELITE Rruga "Shkëlqim Fusha", Pallati "Matrix Konstuksion", Kati 1, Nr. Pasurie 104/81-N4, Volumi 26, Faqe 89, Zone Kadastrale 3292 Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.2, rruga Dervish Hima, Pallati Ambasador 3, Kati 3, Apartamenti nr.17 Tirane Farke LUNDER Rruga Nacionale Tirane Elbasan, Godina e Brunos Space, Qendra Tregtare Teg, perbale hyrjes Viole.	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: Balfin - Balkan Finance Investment Group E-Mail: e.muka@balfin.al Telefon: 0682078403 Të Tjera: DOREZIM BILANCI PER VITIN 2007 Ne baze te vendimit dt. 14-07-2009 eshte caktuar si ekspert per zmadhimin e kapitalit Z. Nexhip Çeçi. Depozitim i vendimit te asamblese se ortakeve te shoqerise date 11.01.2010 per emerimin e Znj. Vera Lala ne cilesine e ekspertit kontabel te shoqerise Balfin shpk. Ne ceshtjen me numer CN-481852-12-10 behet shenimi: Depozitim i vendimit te shoqerise date 20.12.2010 per ndryshimin ekspertit kontabel te shoqerise Balfin Shpk, Znj. Vera Lala dhe emerimin ne vend te saj te	

*[Handwritten signature]*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

**EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E  
SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"**

**GJENDJA E REGJISTRIMIT**

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L42304017T	
2. Data e Regjistrimit	04/11/2014	
3. Emri i Subjektit	ALBANIAN ENERGY SUPPLIER	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	28/10/2014	
6. Kohëzgjatja	Nga: 28/10/2014	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Brigada e 8, Pallati 19, Kati 3, Ap.3	
8. Kapitali	101.302.600,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Import, eksport, tregtim dhe furnizim me shumice dhe pakice te energjise elektrike. Ndertimi, zhvillimi dhe menaxhimi i impianteve, sistemeve, te prodhimit, shperndarjes, transmetimit te energjise elektrike. Shitja, blerja, dhenia me qira e pasurive te paluajteshme. Ofrimi i sherbimeve te konsulences, projektimit inxhinierik dhe asistences teknike. Çdo veprimtari tjetër që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për realizimin e qëllimit të Shoqërisë dhe që nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar në fuqi	
10. Administratori/ët	Megi Hadushi	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 18/11/2020	Deri: 18/11/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)		
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Nexia AL	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 03/03/2021	Deri:
13. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Dega në Shqipëri e Shoqërisë ERNST & YOUNG -	

*Aplicancë  
me fjalë*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



13.1 Afati i emërimit	EKSPERTE KONTABEL TE AUTORIZUAR	
	Nga: 24/07/2020	Deri:
14. Ortakët	Balfin - Balkan Finance Investment Group	
14.1 Vlera e kapitalit	Para: 101.302.600,00	Natyre:
14.2 Numri i pjesëve	100,00	
14.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
14.4 Komente (nëse ka)		
15. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	Elbasan Paper PAPER Uzina e Ferrokromit Elbasan, Zona Industriale, Njesia Administrative Paper	
16. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: ALBANIAN ENERGY SUPPLIER E-Mail: f.lama@balfin.al Telefon: 042389250	
17. Statusi:	Aktiv	

Datë: 23/12/2021

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



Vulosur elektronikisht nga  
Qendra Kombëtare e Biznesit  
Date: 2021/12/23 11:57:52 +01:00  
L42304017T2021122311573424  
2006

2

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë  
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra Kombëtare e Biznesit)

*Polikant*  
*Spinejta*  
*[Signature]*